



## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Department Slobodnih Profesija- Department of Freelance Professions

### Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr. 53/2021

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të Komisionit Disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbarueses private znj. [ ] si organ përmbarues e emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në [ ], pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, palës ankuese z. [ ], dhe pas seancës këshillimore dhe votimit, me datën 21.12.2021, me shumicë votash, mori si në vijim:

### V E N D I M

- I. Organi përmbarues-Përmbaruesja Private znj. [ ] e emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në [ ] është përgjegjëse për shkelje disiplinore nga neni 367 par 1, pika 1.2 të LPP-së.
- II. Për kryerjen e kësaj vepre disiplinore, përmbarueses private, znj. [ ] i shqiptohet masa disiplinore "gjobë në të holla," në shumën prej 1.000 € (Njëmijë Euro) e paraparë me nenin 368 par 1, pika 1.3, të LPP-së.
- III. Detyrohet përmbaruesja private, znj. [ ] që të bëjë pagesën në emër të gjobës së shqiptuar me këtë vendim, në llogarinë bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës, brenda afatit prej një (1) muaji duke e llogaritur nga dita e dorëzimit të këtij vendimi përmbaruesit privat.

### A R S Y E T I M

Me datën 15.11.2021, përkatësisht me datën 17.11.2021, pala ankuese z. [ ], nga [ ], ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj përmbarueses private znj. [ ] e emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në [ ]. Pala ankuese pretendon që përmbaruesja private znj. [ ] me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore në lëndën P. nr 162/21 ka bërë shkelje të procedurave të përmbarimit duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Përmbarimore. Sipas palës ankuese, përmbaruesja private i ka bllokuar

llogarinë bankare dhe automjetin për një borxh të rrymës për të cilin ai nuk ka asnjë dokument. Pala ankuese pretendon se është njoftuar vetëm gojarisht përmes punëtorëve të përmbarueses private por që përkundër kërkesë së tij për t'iu dorëzuar shkresat që të ushtrojë mjetin juridik në gjykatë, shkresat e lëndës nuk i janë ofruar. Pala ankuese thekson që nga viti 2006 është larguar nga banesa në fjalë, më tutje në atë banesë ka jetuar dikush tjetër dhe rrjedhimisht ai nuk ka borxh KEDS – it.

Me datën 23.11.2021, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar ndaj përmbarueses private znj. \_\_\_\_\_ si organ përmbarues e emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në \_\_\_\_\_, duke i propozuar Komisionit Disiplinor që në përputhje me nenin 373 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, të ndërmarr veprimet e nevojshme lidhur me këtë lëndë përmbarrimore.

Përmbaruesja private znj. \_\_\_\_\_, në përgjigjen e saj ka bashkangjitur dokumentacionin e lëndës.

Me datën 21.12.2021, Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, pala ankuese z. \_\_\_\_\_ ndërsa përmbaruesja private znj. \_\_\_\_\_ ka njoftuar Komisionin Disiplinor paraprakisht që nuk mund të merr pjesë në seancën dëgjimore për shkak të gjendjes shëndetësore të vajzës së saj.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbaruesja private znj. \_\_\_\_\_, ka kryer vepër disiplinore.

Komisioni Disiplinor gjen se përmbaruesja privat znj. \_\_\_\_\_ ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe tejkalluar autorizimet e saj ligjore duke mos i dhënë qasje palës debitore në shkresat e lëndës. Neni 9 i LPP-së, përcakton detyrimin e organit përmbarues përkatësisht përmbarueses private në katë rast, për mbrojtjen e dinjitetit të debitorit gjatë ndërmarrjes së veprimeve përmbarrimore. Specifikisht kërkohet që *“Gjatë zbatimit të procedurës së përmbarrimit, duhet kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit të debitorit, dhe përmbarrimi të jetë sa më pak i dëmshëm që është e mundshme për debitorët.”* Bazuar në shkresat e lëndës, përkatësisht shkresën nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës Ref.00950/21 dt 09.11.2021, pala ankuese ka jetuar në pronën e cila gjendet në rrugën “Bajo Topulli “ nr 19, Prizren, brenda periudhës 2003 deri në vitin 2006. Pas këtij viti pala ankuese nuk ka jetuar në këtë banesë. Ndërsa, faturat për shpenzimet e rrymës për të cilat është zbatuar procedura përmbarrimore i referohen periudhës pas vitit 2006. Sipas palës debitore, ai asnjëherë nuk kishte pranuar urdhrin përmbarrimor për ta kundërshtuar. Ai është njoftuar lidhur me procedurën përmbarrimore vetëm pasi qendra e regjistrimit të automjeteve e kishte njoftuar se ka një ndalesë të lëshuar nga përmbaruesja private znj. \_\_\_\_\_. Pala ankuese kishte kontaktuar përmbaruesen private znj. \_\_\_\_\_ për të kërkuar informacione lidhur me çështjen përmbarrimore sepse pretendon që ato shpenzime lidhur me rrymën nuk mund t'i faturohen atij duke qenë që nuk ka jetuar në atë banesë kohën kritike. Kjo evidentohet nga shkresa e dorëzuar nga pala ankuese përmes adresës elektronike për përmbaruesen private dt 09.11.2021. Përmbaruesja private znj. \_\_\_\_\_ nuk i kishte kthyer përgjigje dhe nuk i kishte ofruar shkresat. Duke mos i dhënë qasje në shkresat e lëndës, në vlerësimin e Komisionit Disiplinor, përmbaruesja private znj. \_\_\_\_\_ ka shkelur ligjin sepse efektivisht

i ka pamundësuar ushtrimin e mjetit juridik për të kundërshtuar borxhin të cilin pala ankuese pretendon që nuk mund t'i atribuohet atij dhe për të sfiduar veprimet ligjore të ndërmarra nga ana e përmbareshes private znj. . Siç u theksuar më lartë, rasti për shkelje disiplinore është raportuar me dt datën 15.11.2021, përkatësisht me datën 17.11.2021. Me datën 24.11.2021, përmbareshja privatë znj. ishte njoftuar se ndaj saj kishte filluar procedura disiplinore dhe nga e njëjta është njoftuar që ka të drejtë të jap mendimin e saj përkitazi me pretendimet e ngritura për shkeljet e pretenduara disiplinore. Me dt 03.12.2021, përmbareshja privatë znj. i dërgon shkresat palës debitorë. Kjo do të thotë, në vlerësimin e Komisionit Disiplinor, se përmbareshja privatë znj. , kishte ofruar shkesat e lëndës palës ankuese-debitorë vetëm pasi ishte njoftuar për procedurën disiplinore ndaj saj. Rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor vlerëson se veprimet e përmbareshes private znj. duke refuzuar, pa ndonjë arsye, që palës debitorë t' jap informacionet e kërkuara përbëjnë shkelje ligjore sepse, në thelb, mosdhënia e informacioneve cenon të drejtën e shfrytëzimit të mjetit juridik si një e drejtë themelore.

Komisioni vlerëson se masa e shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore individuale të përmbareshes private znj. , është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë edhe tek përmbareshit tjerë privat që t'iu përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit të tyre ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbareshore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, është edhe qëllimi i masave disiplinore sipas Ligjit për procedurën përmbareshore.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARESHIT PRIVAT**  
**DPL.nr 53/2021, datë 21.12.2021**

**Kryesues i Komisionit Disiplinor**  
**Adnan ISUFI**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

The first part of the document discusses the importance of maintaining accurate records of all transactions. It emphasizes that every entry should be supported by a valid receipt or invoice. This ensures transparency and allows for easy verification of the data.

Furthermore, it is noted that regular audits are essential to identify any discrepancies or errors early on. This proactive approach helps in maintaining the integrity of the financial statements and prevents any potential issues from escalating.

In conclusion, the document stresses that a robust system of record-keeping is not only a legal requirement but also a key to the success of any business. By adhering to these principles, organizations can ensure that their financial data is reliable and trustworthy.



The second part of the document provides a detailed overview of the current market conditions. It highlights the challenges faced by various sectors and offers insights into the potential opportunities for growth.

The analysis indicates that while there are uncertainties in the global economy, there are also significant areas where investment and innovation can drive progress. Organizations are encouraged to stay agile and responsive to market changes.

Overall, the document serves as a comprehensive guide for navigating the current economic landscape, providing valuable information for decision-makers in various industries.